

Më 10 dhjetor të vitit 1948, Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara nxori dhe shpalli Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut, tekstin e plotë të së cilës po e botojmë në faqet që vijojnë. Pas këtij akti historik, Asambleja ftoi të gjitha shtetet anëtare që ta shpallin tekstin e Deklaratës dhe të përpiqen që të përhapet, të paraqitet, të lexohet dhe të shpjegohet sidomos në shkolla dhe institucione të tjera edukative të të gjitha vendeve dhe shteteve pa marrë parasysh statusin e tyre politik.

Teksti zyrtar i Deklaratës është në gjashtë gjuhë zyrtare të Kombeve të Bashkuara: angleze, frënge, kineze, ruse, spanjolle dhe arabe.

## **DEKLARATA UNIVERSALE PËR TË DREJTAT E NJERIUT**

### **HYRJE**

Meqë njohja e dinjitetit të lindur të të drejtave të barabarta dhe të patjetërsueshme të të gjithë anëtarëve të familjes njerëzore është themel i lirisë, drejtësisë dhe paqes në botë; meqë mosrespektimi dhe përbuzja e të drejtave të njeriut çonte drejt veprimeve barbare, që fyenin ndërgjegjen njerëzore, dhe meqë krijimi i një bote në të cilën njerëzit do të gëzojnë lirinë e fjalës, lirinë e besimit dhe lirinë nga frika dhe skamja është shpallur si aspirata më e lartë e çdo njeriu;

meqë është qenësore që të drejtat e njeriut të mbrohen nga sistemi juridik ku do të sundojë ligji, që njeriu të mos shtrëngohet të rebelohet dhe të ngritet kundër tiranisë dhe shtypjes, duke përdorur atë si mjet të fundit;

meqë është qenësore që të nxitet zhvillimi i marrëdhënieve miqësore ndërmjet kombeve;

meqë popujt e Kombeve të Bashkuara përsëri shpallën në Kartë besimin e tyre në të drejtat themelore të njeriut, në dinjitetin dhe në vlerën e personalitetit të njeriut dhe në barazinë midis burrave e grave dhe vendosën të nxisin përparimin shoqëror dhe të përmirësojnë nivelin e jetesës në një liri më të plotë;

meqë shtetet anëtare u zotuan që në bashkëpunim me Kombet e Bashkuara të sigurojnë respektimin e përgjithshëm dhe zbatimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut;

meqë kuptimi i përbashkët i këtyre të drejtave dhe lirive është më i rëndësishëm për realizimin e plotë të këtij zotimi;

**ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME** e OKB-së shpall

këtë **DEKLARATË UNIVERSALE PËR TË DREJTAT E NJERIUT** si ideal të përbashkët të cilin duhet ta arrijnë të gjithë popujt dhe të gjitha kombet, në mënyrë që çdo njeri dhe çdo organizëm i shoqërisë, duke pasur parasysh gjithnjë këtë Deklaratë, të synojnë që me anë të arsimit dhe edukimit, t'i kontribuojnë respektimit të këtyre të drejtave dhe lirive dhe që me masa progresive kombëtare dhe ndërkombëtare të sigurojnë njohjen dhe zbatimin e tyre të përgjithshëm dhe të njëmendtë, si midis popujve të vetë shteteve anëtare, ashtu edhe midis popujve të atyre territoreve që ndodhen nën administrimin e tyre.

**Neni 1.**

Të gjithë njerëzit lindin të lirë dhe të barabartë në pikëpamje të dinjitetit dhe të të drejtave. Ata janë të pajisur me arsye dhe ndërgjegje dhe duhet të sillen ndaj njëri tjetrit në një frymë vëllazërore.

**Neni 2.**

Secilit i përkasin të gjitha të drejtat dhe liritë e shpallura në këtë Deklaratë pa kurrfarë dallimesh në pikëpamje të racës, ngjyrës, seksit, gjuhës, fesë, mendimit politik ose çdo mendimi tjetër, të prejardhjes kombëtare a shoqërore, të pasurisë, të lindjes apo të ndonjë gjendje tjetër juridike.

Përveç kësaj, nuk do të bëhen kurrfarë dallimesh në bazë të statusit politik, juridik apo ndërkombëtar të vendit ose territorit të cilit i përket ndonjë individ, qoftë kur ky vend ose territor është i pavarur, apo kur ndodhet nën kujdestari ose është jovetëqeverisës a nën çfarëdo kufizimi tjetër të sovranitetit.

**Neni 3.**

Secili ka të drejtë të jetojë, të jetë i lirë dhe të ketë siguri vetjake.

**Neni 4.**

Askush nuk duhet të mbahet në robëri ose detyrimisht i nënshtruar; robëria dhe tregtia me robër janë të ndaluara në të gjitha format.

**Neni 5.**

Askush nuk duhet t'i nënshtrohet torturës, a trajtimeve ose dënimeve të tjera mizore, çnjerëzore ose poshtëruese.

**Neni 6.**

Secili ka të drejtë që të pranohet çdokund si subjekt juridik përpara ligjit.

**Neni 7.**

Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit dhe kanë të drejtë që, pa kurrfarë diskriminimi, të mbrohen njësoj nga ligji. Të gjithë kanë të drejtën për mbrojtje të barabartë kundër çdo diskriminimi që do të shkelte këtë Deklaratë, dhe kundër çdo nxitjeje për një diskriminim të tillë.

**Neni 8.**

Secili ka të drejtë që me mjete juridike efektive para gjykatave kompetente kombëtare të mbrohet nga veprimet e shkeljes së të drejtave themelore të garantuara me kushtetutë a me ligj.

**Neni 9.**

Askush nuk duhet të arrestohet, të burgoset, ose të dëbohet arbitrarisht.

#### **Neni 10.**

Secili ka të drejtë plotësisht të barabartë për gjykim të drejtë dhe publik para një gjykate të paanshme e të pavarur që do të vendosë për të drejtat dhe detyrimet e tij dhe për mbështetshmërinë e çdo akuze penale kundër tij.

#### **Neni 11.**

1. Secili që akuzohet për një vepër penale ka të drejtë të konsiderohet i pafajshëm derisa në bazë të ligjit të vërtetohet fajësia në një proces publik në të cilin i sigurohen të gjitha garancitë e nevojshme për mbrojtjen e tij.

2. Askush nuk duhet të dënohet për veprime ose lëshime të cilat, në kohën kur janë kryer ato, nuk përbënin një vepër penale sipas ligjeve kombëtare a ndërkombëtare. Gjithashtu, nuk duhet të jepet një dënim më i rëndë se ai që ka mund të zbatohet në kohën kur është kryer vepra penale.

#### **Neni 12.**

Askush nuk duhet t'i nënshtrohet ndërhyrjes arbitrare në jetën e tij private, në familje, në banesë ose në letërkëmbim vetjak, as sulmit kundër nderit dhe dinjitetit të tij. Secili ka të drejtën të mbrohet me ligj kundër ndërhyrjeve ose sulmeve të tilla.

#### **Neni 13.**

1. Secili ka të drejtën e lirisë së qarkullimit dhe të zgjedhjes së vendbanimit brenda kufijve të një shteti.

2. Secili ka të drejtë të braktisë cilindo vend, duke përfshirë këtu edhe vendin e tij, si dhe të kthehet në vendin e tij.

#### **Neni 14.**

1. Secili ka të drejtë të kërkojë dhe të gëzojë vendstrehim në vende të tjera për shkak të përndjekjes.

2. Këtë të drejtë nuk mund ta kërkojë askush në rast të përndjekjeve që mbështeten vërtet në veprimet e rëndomta penale ose në veprimet që janë në kundërshtim me qëllimet dhe parimet e Kombeve të Bashkuara.

#### **Neni 15.**

1. Secili ka të drejtën e një shtetësie.

2. Askush nuk duhet të privohet arbitrarisht nga shtetësia e tij, e as nga e drejta për të ndërruar shtetësinë.

#### **Neni 16.**

1. Burrat dhe gratë e moshës madhore kanë të drejtë të lidhin martesë dhe të krijojnë familje, pa kurrfarë kufizimesh në pikëpamje të racës, të shtetësisë ose të fesë. Ata kanë të drejta të barabarta ndaj martesës, gjatë martesës dhe në kohën kur ajo prishet.

2. Martesa duhet të lidhet vetëm me pëlqimin e lirë dhe të plotë të bashkëshortëve të

ardhshëm.

3. Familja është njësi e natyrshme dhe thelbësore e shoqërisë dhe ka të drejtën e mbrojtjes nga shoqëria dhe shteti.

#### **Neni 17.**

1. Secili ka të drejtë të ketë pasuri, vetë dhe në bashkësi me të tjerët.
2. Askush nuk duhet të privohet arbitrarisht nga pasuria e tij.

#### **Neni 18.**

Secili ka të drejtën e lirisë së mendimit, të ndërgjegjes dhe të fesë; kjo e drejtë përfshin lirinë e ndërrimit të fesë a të bindjeve dhe lirinë që njeriu, qoftë vetë ose në bashkësi me të tjerët, të shfaqë publikisht ose privatisht fenë a bindjen e vet, nëpërmjet arsimit, praktikës, kryerjes së kultit dhe riteve fetare.

#### **Neni 19.**

Secili ka të drejtën e lirisë së mendimit dhe të shprehjes; kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit pa ndërhyrje, si dhe lirinë e kërkimit, marrjes dhe përhapjes së informacionit dhe ideve me çfarëdo mjetesh, pa marrë parasysh kufijtë.

#### **Neni 20.**

1. Secili ka të drejtën e lirisë së mbledhjes dhe bashkimit paqësor.
2. Askush nuk mund të detyrohet t'i takojë ndonjë shoqate.

#### **Neni 21.**

1. Secili ka të drejtë të marrë pjesë në qeverisjen e vendit të vet, drejtpërsëdrejti ose me anë të përfaqësuesve të zgjedhur lirisht.
2. Secili ka njësoj të drejtë të hyjë në shërbimet publike të vendit të vet.
3. Vullneti i popullit është bazë e pushtetit shtetëror; ky vullnet duhet të shprehet në zgjedhjet e herëpashershme dhe të lira, të cilat duhet të jenë të përgjithshme dhe me votë të barabartë, si dhe me votim të fshehtë ose sipas procedurës përkatëse të votimit të lirë.

#### **Neni 22.**

Secili, si anëtar i shoqërisë, ka të drejtë sigurimi social dhe të drejta të domosdoshme ekonomike, sociale e kulturore për dinjitetin e tij dhe për zhvillimin e lirë të personalitetit të tij, me ndihmën e shtetit dhe bashkëpunimit ndërkombëtar dhe në përputhje me organizimin dhe burimet e çdo shteti.

#### **Neni 23.**

1. Secili ka të drejtë të punojë, të zgjedhë lirisht punën, të ketë kushte të kënaqshme dhe të favorshme pune dhe të jetë i mbrojtur nga papunësia.
2. Secili, pa kurrfarë diskriminimi, ka të drejtë që për punë të barabartë të marrë rrogë të barabartë.
3. Secili që punon ka të drejtë për një shpërblim të drejtë dhe të favorshëm, në mënyrë

që t'i sigurojë atij dhe familjes së tij një jetë që i përgjigjet dinjitetit njerëzor dhe që, po qe se është e nevojshme, do të plotësohet me mjete të tjera të mbrojtjes sociale.

4. Secili ka të drejtë të formojë e t'u bashkohet sindikatave për mbrojtjen e interesave të tij.

#### **Neni 24.**

Secili ka të drejtë për pushim dhe kohë të lirë, duke përfshirë kufizimin e arsyeshëm të orarit të punës dhe pushimin e paguar të herëpashershëm.

#### **Neni 25.**

1. Secili ka të drejtë për një nivel jetese që siguron shëndetin dhe mirëqenien e tij dhe të familjes së tij, duke përfshirë këtu ushqimin, veshmbathjen, strehimin, kujdesin mjekësor dhe shërbimet e nevojshme sociale, si dhe të drejtën për të qenë i siguruar në rast papunësie, sëmundjeje, invaliditeti, vejërie, pleqërie ose në raste të tjera të mungesës së mjeteve të jetesës për shkak të rrethanave që nuk varen nga vullneti i tij.

2. Nënata dhe fëmijët kanë të drejtën për kujdes dhe ndihmë të posaçme. Të gjithë fëmijët, të lindur në marrëdhënie martesore apo jashtëmartesore, gëzojnë mbrojtje të njëjtë sociale.

#### **Neni 26.**

1. Secili ka të drejtën e arsimit. Arsimi duhet të jetë falas, të paktën në fazat e arsimit fillor dhe themelor. Arsimi fillor është i detyrueshëm. Arsimi teknik dhe profesional duhet të jetë i përgjithshëm, ndërsa arsimi i lartë duhet t'u bëhet i mundshëm të gjithëve në mënyrë të barabartë në bazë të aftësisë.

2. Arsimi duhet të synojë zhvillimin e plotë të personalitetit të njeriut dhe forcimin e respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Ai duhet të nxitë mirëkuptimin, tolerancën dhe miqësinë midis të gjitha kombeve, grupeve raciale ose fetare, si dhe veprimtarinë e Kombeve të Bashkuara për ruajtjen e paqes.

3. Prindërit kanë të drejtën parësore për zgjedhjen e llojit të arsimit për fëmijët e tyre.

#### **Neni 27.**

1. Secili ka të drejtë të marrë pjesë lirisht në jetën kulturore të bashkësisë, të gëzojë artet dhe të marrë pjesë në përparimin shkencor dhe në dobitë që sjell ajo.

2. Secili ka të drejtë të mbrojë interesat morale dhe materiale që rrjedhin nga çdo krijimtari shkencore, letrare ose artistike, krijues i të cilave është ai vetë.

#### **Neni 28.**

Secili ka të drejtë për një rend shoqëror dhe ndërkombëtar në të cilin mund të realizohen plotësisht të drejtat dhe liritë e shpallura në këtë Deklaratë.

#### **Neni 29.**

1. Secili ka detyrime ndaj bashkësisë ku vetëm aty i mundësohet zhvillimi i lirë dhe i plotë i personalitetit të tij.

2. Në ushtrimin e të drejtave dhe lirive të veta, secili do t'u nënshtrohet vetëm atyre kufizimeve të cilat janë përcaktuar me ligj, vetëm me qëllim të sigurimit të njohjes dhe të respektimit të domosdoshëm të të drejtave dhe lirive të të tjerëve dhe të plotësimit të kërkesave të drejta të moralit, të rendit publik dhe të mirëqenies së përgjithshme në një shoqëri demokratike.

3. Këto të drejta dhe liri kurrësi nuk mund të ushtrohen në kundërshtim me qëllimet dhe parimet e Kombeve të Bashkuara.

**Neni 30.**

Asnjë dispozitë e kësaj Deklarate nuk mund të interpretohet si e drejtë e një shteti, grupi apo personi për të zhvilluar çfarëdo veprimtarie ose për të kryer një akt që synon shkeljen e të drejtave dhe lirive të përmbledhura e të shpallura në këtë Deklaratë.

(Përkthyer nga Zyra e Komisarit të Lartë të Kombeve të Bashkuara Për të Drejtat e Njeriut)